



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Komuna Istog shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

| | |
|-----------------------------------|-------------------------------------|
| Titulli i pozitës së punës | Zyrtar për Regjistrim të Bizneseve |
| Klasa e pozitës | Profesional 3 |
| Koeficienti/Paga | 7 |
| Nr. i kërkuar | 1 |
| Data e njoftimit | 27/10/2022 |
| Afati për aplikim | 11/11/2022 - 18/11/2022 |
| Institucioni | Komuna Istog |
| Departamenti | Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim |
| Divizioni | |
| Vendi i punës | Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim |
| Nr. i Referencës | RN00010294 |
| Kodi | RPC0003989 |



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Bënë pranimin e aplikacioneve për regjistrim fillestar të biznesit, ndryshimet dhe shuarjen e biznesit;
2. Bënë përpunimin e të dhënave për regjistrim të bizneseve dhe emrave tregtarë;
3. Kryen kontrollimin e të dhënave në aplikacionet për regjistrim të bizneseve ose emrave tregtarë të dorëzuara nga biznesi dhe bëjnë validimin e emrit të biznesit ;
4. Bënë futjen e të dhënave në sistemin e para regjistrimit në bazë të tipareve të biznesit;
5. Krijon arkivin elektronik në para regjistrim duke skanuar dokumentacionin ;
6. Ofron këshilla për aplikuesit e bizneseve – regjistrimin e tyre sipas kërkesave të tyre;
7. Kryen edhe detyra tjera që caktohen nga DEZH në pajtim me dispozitat ligjore dhe rregulloret në fuqi.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare, Fakulteti Ekonomik dhe i Biznesit, me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to;
- Kualifikime të posaçme formale ;
- Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet përvojë pune.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikën operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).



Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

